



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DEÇAN/ OPŠTINSKI SUD ZA PREKRŠAJE U
DEČANIMA/ MUNICIPAL MINOR OFFENCES COURT IN DEÇAN

Regj.Nr. 2435 / 12

Gjykata Komunale per Kundërvajtje në Deçan, me gjyqtarin Nexhat Musaj dhe sekretaren juridike Hasime Qorraj duke vendosur në procedurën kundërvajtëse ndaj te pandehurit Rasim Hasan Maloku nga Juniku , për shkak te shkeljes se dispozites se nenit 17 paragrafi 1,1 te Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë te Zyrtareve te Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te gjithë Personat Zyrtarë , e në veshtrim me dispozitat e nenit 30.123,195 dhe nenit 198 pika 2 te Ligjit mbi Kundërvajtjet me dt.20.09.2012 bie kete:

A K T E V E N D I M

PEZULLOHET , procedura kundërvajtëse ndaj te pandehurit Rasim Hasan Maloku nga Juniku, për shkak te shkeljes se dispozites se nenit 17 paragrafi 1,1 te Ligjit për Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë te Zyrtareve te Lartë Publik dhe Deklarimin ,Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për te gjithë Personat Zyrtarë, konform nenit 198 pika 2 te Ligjit mbi Kundërvajtjet për shkaqe te argumentuara në arsyetim te ketij aktevendimi.

A R S Y E T I M

REPUBLIKA E KOSOVES –AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT –PRISHTINË me kerkesen nr. 01-2340-12 te dates.02.07.2012 ju ka drejtuar kesaj gjykate qe ndaj te pandehures te zhvillohet procedura kundërvajtëse dhe pas sigurimit te provave te duhura te shpallet fajtores dhe te denohet në bazë te Ligjit.

Me zhvillimin e procedures kundërvajtëse i pandehuri Rasim Maloku , ne mbrojtjen e vet ka deklaruar : Lidhur me kundervajtjen per te cilen me ngarkon Agjesia Kunder Kurrupcionit ne Prishtinë : kam per te deklaruar se per vitin 2011 unë e kam deklaruar pasurinë ne Agjensionin Kosovar kunder kurrupcionit per vitin 2011 me daten .30.03.2012 .Si provë deshmie gjykates i prezenton vertetimin e fletëparanimit te dokumentacionit perkates per deklarimin e prejardhjes dhe gjendjes se pasurisë me nr.03-2060/2012 te dates. 30.03.2012.

Andaj Gjykata duke u bazuar në deklaraten e te pandehurit , proven e prezentuar nga ana e te pandehurit ,ka ardhur ne perfundim qe te pezullohet procedura kundërvajtëse , andaj ne bazë te rrethanave qe u ceken më lartë është pezulluar procedurën kundërvajtëse konformë nenit 198 pika 2 te Ligjit mbi Kundërvajtjet.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv te ketij aktevendimi.

Me nga një kopje te ketij aktevendimi njoftohen ushtruesi i kërkeses dhe i pandehuri

U VENDOS NË GJYKATEN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË DEÇAN Regj.nr
2435 /12 dt 20.09.2012

UDHZIM JURIDIK :

Kundër ketij aktevendimi pala e pa knaqur ka drejtë të kërkojë ankesë në afat prej 8 ditesh pas marrjes se ketij aktevendimi. Ankesa ushtrohet në palatën e gjykatës për Gjykatën e Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë.

